



Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Autoriteti i Konkurrencës
Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority



Vendimi Nr .114/23
Datë: 12.12.2023
Nr. Prot: 609/23-02/D

Duke u bazuar në nenet 26, 27 dhe çështjet procedurale të përcaktuara sipas nenit 11, 13, 15, 16, 17, 18 paragrafi 8 nënparagrafi 8.3, 35, 36, 39, 51 dhe 55 paragrafi 1.5 të Ligjit 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës, Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2012 Për Mënyrën e Paraqitjes së Kërkesës dhe Kriteret për Konstatimin e Përqendrimit të Ndërmarrjeve dhe Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 Për Mënyrën e Përcaktimit të Tregut Relevant, Komisioni i Autoritetit i Konkurrencës, në mbledhjen e datës 12.12.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. NDALOHET përqendrimi i ndërmarrjeve MTS d.o.o., dhe/mbi Net Plus d.o.o., lidhur me blerjen e 100% të aksioneve.

Arsyetim

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës me datë; 07.04.2023, me Nr. Prot. 155/23-01//H ka pranuar kërkesën për njoftim të Përqendrimit lidhur me blerjen e aksioneve nga MTS D.O.O., mbi NET PLUS D.O.O.

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës me datë; 05.06.2023, me Nr. Prot. 264/23-01//D, ka hapur Konkluzion për fillimin e procedurës për vlerësim të Përqendrimit ndaj ndërmarrjeve MTS D.O.O., dhe Net Plus D.O.O.

Procedurat e ndjekura:

1. Vlerësimi i Lëndës
2. Vërtetimi për Kërkesën e Dorëzuar me datë 05.05.2023.
3. Njoftimit për realizimin e përqendrimit në web faqen e AKRK-së me datë. 12.04.2023
4. Njoftimi për Përqendrim është i bazuar në Kontratën për shitblerje të aksioneve të lidhur me datën 30.03.2022.
5. Më datë; 05.06.2023, me Nr. Prot. 264/23-01//D, ka hapur Konkluzion për fillimin e procedurës për vlerësim të Përqendrimit ndaj ndërmarrjeve MTS D.O.O., dhe Net Plus d.o.o.

MTS d.o.o., është kompani në pronësi të plotë të Telekom Srbija a.d, me adresë të regjistruar në: Takovska 2, 11000 Beograd, Serbia. Operatori i shpërndarjes MTS D.O.O., me seli në Mitrovicën Veriore, operon në këto komuna: Mitrovica Veriore, Leposaviq, Zubin Potok, Zveqan, Vushtri, Novobërdë, Gjilan, Partesh, Shtërpce, Graçanicë dhe komuna e Fushë Kosovës.

Operatori MTS D.O.O., është themeluar në tetor të vitit 2015, në përputhje me Marrëveshjen e Brukselit dhe Planin e Veprimit nga sfera e telekomunikacionit, me qëllim të kryerjes së aktivitetit të telekomunikacionit në territorin e Kosovës. Marrëveshja ra dakord që Kosova të marrë kodin e saj të zonës - 383 dhe që Telekom Srbija të regjistrohet në sistemin e Kosovës dhe të aplikojë për licencë të telefonisë mobile në mënyrë që, sipas palës kosovare, të vazhdojë përkohësisht të operojë në Kosovë. Është i regjistruar për ofrimin e shërbimeve të mëposhtme të komunikimeve elektronike: Shërbimet e rrjetit publik fiks: shërbimi i telefonisë zanore, shërbimet me vlerë të shtuar, shërbimi i linjës me qira, shërbimi i transmetimit të të dhënave (qasja në internet), shërbimi i shpërndarjes së përmbajtjes mediatike, Shërbimet e rrjetit publik celular: shërbimi i telefonisë zanore dhe shërbimi i transmetimit të të dhënave. Telekom Srbija a.d. Beograd, është themeluesi i kompanisë së sipërpërmendur të biznesit dhe anëtari i vetëm i saj me 100% të aksioneve.

Më 12 tetor 2015 kompania e re "MTS" D.O.O. Kompania me Përgjegjësi të Kufizuar është themeluar dhe regjistruar në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë me numër të regjistrimit të biznesit 71206742 dhe numër unik identifikimi 81 1164029. Kompania gjendet në Mitrovicë, Kosovë. Aktiviteti kryesor i biznesit të kompanisë është ofrimi i shërbimeve të telekomunikacionit.

NET PLUS D.O.O., me adresë të regjistruar në rrugën; Car Llazari p,n, 10500 Graçanicë, Kosovë me numër unik identifikues 810081414. NET PLUS është kompani në pronësi të Z. Boban Načić, shtetas i Kosovës me adresë në Çagllavicë, 10500 Graçanicë. NET PLUS është kompani aktive në tregun e internetit dhe televizionit kabllor në komunën e Graçanicës, këto shërbime ofrohen përmes kabllor optike (pjesa dërrmuese) dhe rrjetit HFC (rrjet hibrid i bazuar në kabëll të kombinuar fibër dhe koaksiale), në nivel më të ulët në vetëm 3 fshatra rreth Graçanicës. Konkretisht, rreth 90% e konsumatorëve të NET PLUS marrin shërbime përmes kabllor optike ndërsa rreth 10% përmes rrjetit HFC. Bazuar në të dhënat e ARKEP, kompania ka në total 833 konsumator.

Baza juridike:

Sipas nenit 13, të Ligjit 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës, përmbushet detyrimi për të bërë njoftimin e Përqendrimit pasi që:

1.1. pjesëmarrësit në përqendrim kanë mbi njëzet (20) milionë euro qarkullim të përbashkët në tregun ndërkombëtar dhe njëri pjesëmarrës në përqendrim ka mbi një (1)

milion euro, qarkullim në tregun e brendshëm. Po ashtu, ndërmarrjet plotësojnë edhe kriterin sipas paragrafit 1.2 sepse palët në përqendrim janë të regjistruara dhe kanë aktivitetin e tyre në Republikën e Kosovës.

2. Qarkullimi i pjesëmarrësve në përqendrim llogaritet sipas raporteve financiare të vitit financiar që i paraprin vitit të përqendrimit. Nëse parashtruesit nuk kanë arritur të mbyllin raportet financiare vjetore para se të parashtrorin kërkesën për lejimin e përqendrimit, qarkullimi i pjesëmarrësve llogaritet sipas raporteve financiare të vitit të fundit financiar për të cilin janë mbyllur raportet financiare.

3. Nëse pjesëmarrësi i përqendrimit i përket një grupi ndërmarrjesh të lidhura, për qarkullim merren të ardhurat e të gjitha ndërmarrjeve të grupit. Nuk merren parasysh të hyrat nga shitja e mallrave ose shërbimeve brenda grupit.

- a. Parashtruesit e kërkesës kanë për qëllim të ekzekutojnë Marrëveshjen lidhur me shitblerjen e 100% të aksioneve mbi ndërmarrjet Net Plus d.o.o.
- b. Kërkesa për përqendrim është bërë për arsye se Aplikuesit kanë degë të regjistruar në Republikën e Kosovës.

Analiza e Konkurrencës

Në bazë të nenit 4, Paragrafi 1 të Ligjit 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës “Tregu përkatës i produktit/shërbimit përcaktohet tregu që përfshin të gjitha mallrat ose shërbimet që vlerësohen si të këmbyeshme ose të zëvendësueshme nga konsumatori, për arsye të karakteristikave, çmimeve dhe përdorimit të synuar.

Tregu gjeografik do të përcaktohet në bazë të zonës gjeografike ku operon, tregu që përfshin zonën në të cilat ndërmarrjet përkatëse përfshihen në furnizimin dhe kërkesën e mallrave dhe shërbimeve në të cilën kushtet e konkurrencës janë mjaft homogjene dhe mund të dallohen në zonat fqinje”.

Gjithashtu sipas udhëzimit administrativ nr. 02/2018 për Përcaktimin e Tregut Përkatës, tregu përkatës përcaktohet veçmas për çdo rast konkret.

Nga sa më lartë, vlerësojmë se transaksioni i propozuar, do të shkaktojë efekte negative përkitazi me konkurrencën në treg, përkatësisht konsumatorët në zonën në të cilën operojnë ndërmarrjet MTS D.O.O. dhe NET Plus D.O.O., për arsye se, nga ky transaksion tregu në këtë zonë do të pësojë përqendrim të lartë dhe rrjedhimisht ndërmarrja blerëse do të forcojë tutje pozitën e saj dominuese në tregun përkatës, në këto zona nuk ka numër të madh të operatorëve, të cilët ofrojnë shërbime të internetit dhe kabllovikut. Në bazë të analizave të tregut kemi një shkallë të lartë të koncentrimin në tregun përkatës dhe si i tillë do të rezultojë me kufizime potenciale në treg.

Vlerësimi i Konkurrencës

Struktura dhe Shtrirja e Tregut Relevant është përcaktuar duke iu referuar Udhëzimit Administrativ për mënyrën dhe kriteret e përcaktimit të tregut përkatës Nr. 02/2018:

Tregu gjeografik - do të konsiderohet komuna e Graçanicës

Tregu i produktit - do të konsiderohen Shërbimet e Telefonisë Mobile, Internet, Kabllor Optik, Shërbimet e Telefonisë Fikse dhe shpërndarja e shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale, të cilët operojnë me shërbimet e TV kabllore.

Efektet e konkurrencës në tregun përkatës, nga transaksioni i realizuar

Transaksioni i propozuar, do të realizohet në tregun gjeografik të Graçanicës, kërkesa për njoftim të përqendrimit është bërë për arsye se, pala blerëse dhe shitëse janë kompani të regjistruara në Republikën e Kosovës, të cilat operojnë në sektorin e ofrimit të shërbimeve të internetit dhe kabllor. Sipas vlerësimit të përqendrimit, ky transaksion *mund të ndikoj në krijimin dhe forcimin e pozitës dominuese, e cila mund të dëmtoj ndjeshëm konkurrencën*, nga të dhënat e ofruara konsiderojmë se implementimi i transaksionit mund të ketë efekt negativ në tregun përkatës dhe si i tillë ka mundësi të kufizimit ose shtrembërimit të konkurrencës në treg.

Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës vlerëson se Ndalimi i Përqendrimit i paraqitur sipas kërkesës për vlerësimin e përqendrimit për blerjen e 100% të aksioneve ndërmjet MTS d.o.o. (blerës) z. Boban Nivic (shitës) mbi NET PLUS d.o.o., është në pajtim me nenin 12 të Ligjit 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, pasi që nga i njëjti do të ketë për pasojë krijimin dhe forcimin e pozitës dominuese.

Shënim:

Çdo formë e shtrembërimit të konkurrencës, respektivisht sjellje anti - konkurruese do të jetë nën monitorimin e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës.

Kërkesa për Përqendrim, merr epilogun si në dispozitiv të këtij **VENDIMI**.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Këshilla juridike: Kundër këtij Vendimi nuk lejohet ankesa, por pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi në gjykatën kompetente.

AUTORITETI I KONKURENCËS

Neime Binaku Isufi

Kryetare

Kaltrina Sela
Zv. Kryetare

Nafije Osdautaj
Anëtare

Florent Mehmeti
Anëtar

Salihe Gashi Loku
Anëtare

III. Me këtë Vendim të njoftohen:

- Palët
- Arkiva